VENDIM
Nr.257, datë 12.3.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS DUSHK, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Dushk, të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 47 (dyzet e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dushk për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Dushk Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
11-19	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
20,23,24,26,27,28,29,30,31,32, 33,34	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
21,22,25,51,61,67,71, 78,83	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive, kanale të treta).	Në pronësi
88-92	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
94	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
96-98, 117	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës.	Në pronësi
127-135, 144	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje).	Në përdorim
136-137,140	Infrastrukturë (rrugë vendore lulishte, trotuare)	Në pronësi
141-143	Furnizim me ujë të pijshëm	Në pronësi
145	Rrjeti i ndriçimit publik	Në pronësi
153,154,156,155	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore sportive.	Në pronësi
157-162	Shërbim funeral	Në pronësi